




RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS

RAPORTI VJETOR 2005

MISIONI YNË

RRGGK-ja mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe të vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga orientimi politik, religjioz, niveli i arsimimit, moshë, orientimi seksual apo aftësitë e tjera. RRGK-ja përmbush misionin e saj me anë të këmbimeve, përvojave, informatave, avokimeve, partneritetit, rrjetëzimeve dhe hulumtimeve.

PËRMBAJTJA

Letër nga Drejtoresha Ekzekutive	1
---	----------

Hyrje

Objektivat Strategjike.....	2
Anëtarët e Bordit 2005.....	3
Partnerët Tanë.....	4

Programet dhe Aktivitetet 2005

Përpjekjet për Zbatimin e Rezolutës 1325 të OKB-së.....	5
Ngritja e Pjesëmarrjes së Grave në Politikë.....	9
Krijimi i Rrjeteve dhe Këmbimi i Informatave.....	13
Shëndeti i Grave.....	17

Programet e Ardhshme.....	18
----------------------------------	-----------

Anëtarët e RRGK-së.....	19
--------------------------------	-----------

Raporti Financiar.....	25
-------------------------------	-----------

Raporti i Auditit.....	26
-------------------------------	-----------

Stafi.....	27
-------------------	-----------

LETËR NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE

Të dashura anëtare dhe miq te Rrjetit,

Për më se një javë jam duke u munduar të përpiloj këtë letër. Vazhdimisht mendimet më janë të orientuara tek bisedimet mbi statusin final politik të Kosovës, që filloi në vjeshtë të vitit 2005. Nuk brengosem vetëm për fatin politik të Kosovës, por gjithashtu edhe për faktin sepse gjysma e popullatës së saj do të jetë pjesë e një vendimi aq të rëndësishëm. Që nga fillimi i bisedimeve, asnjë femër nuk ka qenë e përfshirë në ekipin shtatë-anëtarësh që është duke negociuar në emër të Kosovës, përderisa Serbia ka vetëm një përfaqësues të gjinisë femërore.

Për disa muaj unë gjendem në një gjendje brengosëse dhe nuk mund të besoj realitetin. Jam e revoltuar kur shoh se pas gjithë atyre viteve të ngritjes së zërit tonë për paqe dhe liri, përfaqësimit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, shpërndarjes së ndihmave humanitare nëpër fshatra të rrethuara, ofrimit të ndihmës shëndetësore, dhe përkrahjes së komunitetit me çdo mundësi që kishim, udhëheqësit tonë "harruan" të na përfshijnë në tavolinën vendim-marrëse. Nuk mund të besoj që përfaqësues të shumtë të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, i cili nënshkroi rezolutën 1325 mbi gratë, paqen dhe sigurinë, e cila siguron rolin e gruas në vendimmarrje, nuk arritën ta zbatojnë këtë rezolutë - si në Kosovë ashtu edhe në vendet tjera post-konfliktit. Jam e dëshpëruar që tentativat tona të shpeshta për avokimin e zbatimit të rezolutës në Kosovë, të cilat do të përshkruhen tutje në këtë raport, janë duke hasur në vesh të shurdhër.

Në mënyrë të përsëritshme jemi munduar që të bëjmë që zërat tonë të dëgjohen. Ne jemi takuar me udhëheqësit tonë politik, duke avokuar tek ata që të afrojnë gratë tek tavolina e negociatave. Ne i kemi shkruar letra Këshillit të Sigurimit, Qeverive të huaja, dhe individëve përgjegjës për procesin e bisedimeve. Jemi thirrur në rezolutën 1325, dokument ligjor ky i cili garanton përfshirjen tonë në vendimmarrjen politike. Prapëseprapë, duket se askush nuk është duke ndryshuar vendimet lidhur me këtë. Gjej shpresë në faktin se procesi i bisedimeve ende nuk ka përfunduar dhe disa udhëheqës vendorë dhe ndërkombëtarë na kanë premtuar se do të përfshijnë gratë në negociata. Ndoshta viti 2006 do të jetë viti në të cilin vendimmarrësit do t'i shndërrojnë premtimet e tyre në vepra.

Gjithashtu ndihem e inkurajuar kur shoh përkushtimin e anëtareve të RRGK për ndryshim. Jam e inkurajuar nga motivimi i tyre për punë, edhe pse ndihma financiare gjendet çdo ditë e më vështirë. Përkundër sfidave profesionale, e në disa raste edhe personale, anëtarët vazhdojnë të jenë të përkushtuara ndaj tentativave të RRGK për të ndërtuar paqen dhe për të përmirësuar pozitën e gruas në Kosovë. Gjithashtu kam mbetur e inkurajuar nga puna e partnerëve tanë vendorë dhe ndërkombëtarë, të cilët vazhdimisht na përkrahin, bëjnë që zërat tonë të dëgjohen dhe i shtyjnë tutje përpjekjet tona për ndryshime.

Sinqerisht,

Igballe Rogova



HYRJE

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RRGGK)

RRGGK i formuar në vitin 2000, ishte një rrjet joformal i grupeve dhe organizatave nga regjione të ndryshme të Kosovës. Më pas RRGGK u zhvillua në një rrjet që avokon për të drejtat e grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar.

RRGGK është rrjet udhëheqës në Kosovë dhe regjion duke përfaqësuar 85 organizata të grave të të gjitha grupeve etnike në Kosovë. Disa prej anëtareve të Rrjetit kanë përvojë dhjetë vjeçare në zhvillimin e komunitetit.

Anëtarët e Rrjetit kontribuojnë në ndryshimet në komunitetin e tyre duke u fokusuar në çështje si arsimimi, shëndetsia, përfaqësimi publik, dhuna ndaj grave, trafikimi, zhvillimi ekonomik dhe përkrahja për persona me aftësi të kufizuara. Ato gjithashtu ofrojnë shërbime të ndryshme për gratë dhe burrat në komunitetin e tyre, duke përfshirë kurse, trajnime, këshillime dhe shkëmbim të informatave. Sipas nevojave, anëtarët e Rrjetit bashkohen për të avokuar për të mirën e interesave të qytetarëve në nivelin lokal dhe qendror.

Objektivat Strategjike 2005 - 2008

Objektivat strategjike të RRGGK për 2005 - 2008 janë:

- Ngritja e vetëdijes tek Gratë dhe Burrat për të Drejtat e Gruas dhe mundësit për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.
- Rritja e pjesëmarrjes së barabartë dhe efektive të gruas në të gjitha nivelet e jetës politike dhe proceset vendim marrëse.
- Rritja e efektivitetit të legjislationit, programeve qeveritare dhe politikave për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.
- Rritja e kontributit të gruas dhe njohja publike e kontributeve të saja për arritjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon.
- Fuqizimi i lëvizjeve të grave në Kosovë dhe rritja e rolit të saj në rajon dhe Botë.

ANËTARËT E BORDIT 2005

Naxhije Buqinca - Kryesuese
Drejtoreshë, Grupi i Grave Vetëranë të Arsimit

Belgjyza Muharremi
Drejtoreshë, Dera e Hapur

Luljeta Vuniqi
Drejtoreshë Ekzekutive,
Qendra Kosovare për Studime Gjinore

Vjosa Dobruna
Kryesuese e Bordit të Radio Televizionit të Kosovës

Behar Selimi
Kolonel, Shërbimi Policor i Kosovës

Delina Fico
World Learning - Shqipëri

Marta Prekpalaj
Drejtoreshë, Motrat Qiriazi

Gjatë mbledhjes vjetore në dhjetor, duke u bazuar në rregulloren e Rrjetit, u mbajtën zgjedhjet për dy anëtarët e rinj të bordit, pasi që Luljeta Vuniqi dhe Marta Prekpalaj mbaruan mandatin e tyre dy vjeçar. Marta Prekpalaj u rizgjodh, kurse Besim Kajtazi nga Ministria për Shërbime Publike u zgjodh në vend të Luljeta Vuniqit.

Partnerët Tanë

Suksesit të aktiviteteve të Rrjetit i kanë ndihmuar partneriteti me organizatat lokale dhe ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare në Kosovë dhe jashtë saj.

Partnerët tanë gjithmonë kanë mbështetur projektet e Rrjetit duke respektuar dedikimin tonë për arritjen e qëllimeve dhe objektivave tona.

Association for Women's Rights in Development (Kanada)

Gratë në të Zeza (Serbi)

Gratë për Gratë (Sarajevë)

Heart and Hand Foundation (SH.B.A)

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut

Network of East-West Women

Open Society Institute - New York

One World

Qendra e Aleancës për Zhvillim (Tiranë, Shqipëri)

Qendra Autonome e Grave (Beograd)

Qendra për Avokime, Hulumtime dhe Trajnime (ATRC)

Qendra për Gratë Viktima të Luftës (Zagreb)

Radio Televizioni i Kosovës (RTK)

Radio Televizioni 21 (RTV21)

Televizioni Kohavizion (KTV)

Urgent Action Fund (SH.B.A)

Përkrahësit Tanë

Rrjeti realizon me sukses projektet e saj duke u falenderuar mbështetjes dhe përkrahjes nga organizata dhe individ që kontribuojnë moralisht, teknikisht dhe materialisht. Dëshirojmë ti falenderojmë këto organizata për përkrahjen e tyre në vitin 2005:

Kvinna till Kvinna (KTK)

Swiss Agency for Development and Cooperation (SDC)

United Nations Fund for Women (UNIFEM)

Urgent Action Fund (UAF)

World Learning

Rreth këtij Raporti

Raporti vjetor i Rrjetit shërben për të informuar anëtarët e Rrjetit, partnerët dhe miqtë për aktivitetet dhe arritjet nga Janari në Dhjetor 2005. Raporti i aktiviteteve dhe programeve është i ndarë duke u bazuar në disa pika kyçe në përpjekjet e Rrjetit në 2005: përpjekjet drejt implementimit të rezolutës 1325 të KB; rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë, krijimin e rrjeteve lokale dhe ndërkombëtare dhe shkëmbimin e informatave dhe shëndetin e grave. Ky raport gjithashtu përfshin një pasqyrë të iniciativave të planifikuara për vitin 2006, si dhe informata për kontaktet me anëtarë të Rrjetit dhe stafin.

Gjatë vitit 2005, RRGKK organizoi iniciativë të ndryshme drejt zbatimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë; punoi drejt ngritjes së pjesëmarrjes së gruas në politikë; krijoi rrjete dhe këmbëu informata në nivel lokal dhe ndërkombëtar; dhe, siguroi informata lidhur me shëndetin e gruas.

PËRPJEKJET PËR ZBATIMIN E REZOLUTËS 1325 TË OKB-së



Rezoluta 1325 na garanton pjesëmarrjen në Negociata
Resolution 1325 guarantees us participation in Negotiations

Data 31 tetor e këtij viti shënoi përvjetorin e pestë të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë. Kjo rezolutë e rëndësishme kërkon përfshirje më të madhe të grave në përpjekjet për zgjidhje të konflikteve dhe krijim të paqes. Gjatë viteve të kaluara, Kosovaret e kanë shfrytëzuar këtë rezolutë për të avokuar në takimet që mbajtën me delegacionet e Këshilli të Sigurimit që vizitonin Kosovën, si dhe në letrat e dërguara tek vendimmarrës të ndryshëm. Në vjeshtë të këtij viti, pas hyrjes së Kosovës në bisedime mbi statusin përfundimtar politik të Kosovës zbatimi i kësaj rezolute u shndërrua në një prioritet edhe më të rëndësishëm për RRGK. Në vitin 2005, RRGK shfrytëzoi rezolutën për të evokuar për të drejtën ligjore dhe demokratike të grave që të marrin pjesë në bisedime, të cilat do të ndikojnë në jetën e tyre dhe në ardhmërinë e shoqërisë së tyre.

Krijimi i Koalicionit Rajonal për zbatimin e RKSOKB 1325

Në prill 2005, aktivistet nga rajoni u takuan në Shkup, të përkrahura nga UNIFEM, për të këmbyer informata, vazhduar diskutimet, dhe përgatitur strategjinë për zbatimin e RKSOKB 1325 në rajon. Ky takim është mbajtur pas dy takimeve tjera që janë mbajtur me të njëjtën temë në Prishtinë (janar 2004) dhe Sarajevë (tetor 2004). Gjatë këtij takimi, RTV21 emitoi një film dokumentar që ishte sajuar gjatë punëtorisë rajonale në Sarajevë, në tetor të vitit 2004. Ky ishte filmi i parë i gjiruar ndonjëherë lidhur me RKSOKB 1325. Në film, udhëheqëset rajonale flasin lidhur me rëndësinë e kësaj rezolute dhe mënyrat në të cilat ato e kanë shfrytëzuar atë. Ky film dokumentar është emituar në RTV21 si dhe në Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci, Serbi, dhe Nju Jork nga UNIFEM dhe DPKO. Pas emetimit të filmit, RTV21 organizoi një debat në të cilin anëtarë të RRGK dhe përfaqësues të qeverisë diskutuan mbi filmin dhe zbatimin e RKSOKB 1325 në Kosovë.

Përpilimi i Raportit mbi Zbatimin e RKSOKB 1325 në Kosovë

Që nga fillimi i majit 2005, UNIFEM, RRGK dhe Gratë për Gratë (Sarajevë) kanë bashkëpunuar për të hulumtuar dhe përpiluar një raport lidhur me nivelin e zbatimit të RKSOKB 1325 në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë. Në Kosovë, RRGK dhe UNIFEM kanë intervistuar organizata të ndryshme lokale dhe ndërkombëtare, qeveritare dhe joqeveritare, lidhur me iniciativat e tyre për zbatimin e RKSOKB 1325, përfshirë edhe PSSP-në, z. SRS Søren Jessen-Petersen. RRGK dhe Gratë për Gratë i kanë dërguar OKB-së një përmbledhje të draftit të raportit me rekomandime në ditën e përvjetorit të pestë të rezolutës. Drafti i raportit është duke u shqyrtuar dhe do t'i dërgohet OKB-së dhe vendimmarrësve tjerë deri në fund të vitit 2006. Si produkt dytësor, edhe vetë procesi i intervistimit ka ngritur vetëdijen e qeveritarëve lidhur me RKSOKB 1325 dhe ka përkrahur bartjen e informatave mes trupave qeveritare dhe joqeveritare. Si rezultat rrjedhimisht janë krijuar edhe partneritete të reja. Themelimi i një njësie gjinore brenda formacioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës është bërë si rezultat i këtij procesi.

Takimi me PSSP-në

Më 10 maj 2005, RRGK dhe Lobi i Grave të Kosovës i kanë dërguar letër PSSP-së, z. Søren Jessen-Petersen, duke kërkuar që gratë të përfshihen në ekipin negociator të Kosovës për statusin final politik të Kosovës si dhe që ai të takohet rregullisht me përfaqësues të grave Kosovare për të diskutuar lidhur me këtë dhe çështje tjera, siç përcaktohet me RKSOKB 1325. Shkurt pas kësaj ngjarje, gratë aktive në politikë dhe shoqëri civile filluan të takohen çdo tre muaj me PSSP-në Søren Jessen-Petersen, me ç' rast ato ngritën zërat dhe brengat e tyre tek vendimmarrësit. Gjatë këtyre takimeve, RRGK dhe gratë tjera vazhdimisht ngrisin çështjen e përfshirjes së grave në bisedimet mbi statusin final politik të Kosovës.

Takimi me Zyrtarët e OKB-së në Nju Jork

Më 28 shtator 2005, në një takim të organizuar nga UNIFEM, pesë përfaqësuese të RRGK u takuan me zyrtarë nga UNIFEM dhe Departamenti për Operacione Paqeruajtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (DPKO), përfshir edhe z. Wolfgang Weisbrod-Weber, Drejtor i DPKO për Divizionin e Evropës dhe Amerikës Latine. Përfaqësueset e RRGK paraqitën brengat e tyre lidhur me mungesën e seriozitetit të kushtuar nga UNMIK-u ndaj çështjeve gjinore dhe pjesëmarrjen e grave në bisedimet për statusin përfundimtar. Zyrtarët e DPKO u pajtuan që të kemi bashkëpunim në të ardhmen dhe u pajtuan se do të na ofrojnë ndihmë duke ndikuar në agjendat e misionëve të nivelit të lartë, në mënyrë që të sigurohen se ata në të ardhmen do të parashohin takime të rregullta zyrtare me organizatat e grave.

Takimi me të Deleguarin Special të OKB-së, Ambasador Kai Aide

Në shtator, gratë Kosovare u takuan me të Deleguarin Special të OKB-së, Ambasadorin Kai Aide. Aktivistet filluan takimin duke diskutuar mbi çështjen e përfshirjes së grave në bisedimet të cilat do të përcaktojnë statusin final të Kosovës. Ambasadori Kai Aide u përgjigj me shaka duke thënë "Mos flisni me mua si burra." Aktivistet lokale mbetën të tronditura dhe u përgjigjën duke theksuar se RKSOKB 1325 u siguron atyre të drejtën e të biseduarit mbi statusin final politik të Kosovës. Ato theksuan rëndësinë e përfshirjes së grave në negociatat për statusin final.

Amnesty International Përkrahë Kërkimin e Zbatimit të RKSOKB 1325 nga ana e RRGK

Në një deklaratë publike të bërë më 31 tetor, Amnesty International kërkoi nga "palët përgjegjëse" që të "përfshijnë gratë dhe komunitetet minoritare në bisedimet mbi statusin final". Specifikisht, organizata theksoi nevojën e përfshirjes së gruas në grupet punuese të ekspertëve. Përveç që i referohej neneve specifike të rezolutës, të cilat ndërlidheshin me Kosovën dhe bisedimet, Amnesty International deklarohet se e përkrah RRGK në kërkimin e përfshirjes së grave në procesin e statusit final, në mënyrë që të arrihet një zgjedhje më e qëndrueshme për të ardhmen e Kosovës. Për deklaratën e plotë, shih: <http://web.amnesty.org/library/Index/ENGEUR700172005?open&of=E-NG-YUG>.

Informimi i Grupit Konsultativ për Strategjinë e Ardhshme të Kosovës për Siguri të Brendshme

Më 10 nëntor 2005, RRGK mori pjesë në takimin e grupit konsultativ për Shqyrtimin e Sektorit të Sigurisë së

Brendshme (ISSR). ISSR paraqet një proces prej tetë fazash për analizimin e nevojave afatshkurta dhe afatgjata për zhvillimin e sigurisë së brendshme të Kosovës, pasi që të jetë përcaktuar statusi final i saj. Si pjesë e këtij grupi, RRGK do të punojë me përfaqësuesit e sektorëve të ndryshëm në informimin, shqyrtimin dhe validimin e secilës pjesë të procesit të ISSR, i cili ndërlidhet drejtpërdrejt me nenin 15 të RKSOKB 1325.

KFOR-i Suedez Zbaton RKSOKB 1325

KFOR-i Suedez ftoi RRGK për të mësuar më shumë lidhur me aktivistet Kosovare dhe punën e tyre. Në këtë takim morën pjesë përfaqësues të bazave ushtarake të KFOR-it Suedez, Finlandez dhe Çek, dhe Shërbimit Policor të Kosovës. Ky takim u mbajt në vijimin e një takimi mes KFOR-it Suedez dhe Kvinna till Kvinna, gjatë të cilit përfaqësuesit e KFOR-it shprehën interesin e tyre për tu takuar me aktivistet Kosovare. Gjatë takimit të mbajtur më 22 nëntor, Igballe Rogove foli në emër të RRGK lidhur me punën e grave në politikë dhe OJQ, para, gjatë dhe pas luftës. Ajo gjithashtu përshkroi pozitën aktuale politike, ekonomike dhe shoqërore të gruas në Kosovë. Përkundër faktit që u deshën gjashtë vite para se të bëhej një ftesë e tillë, RRGK mirëpret këtë iniciativë të KFOR-it Suedez dhe Kvinna till Kvinna. RRGK fuqimisht inkurajon forcat paqeruajtëse anëmbanë botës që të ndërmarrin hapa të ngjashëm drejt zbatimit të RKSOKB 1325.

Takimi Rajonal për Paqe dhe Siguri

Në dhjetor të vitit 2005, Drejtoresha Ekzekutive e RRGK iu bashkëngjiti udhëheqësve politike nga rajoni në Dubrovnik, Kroaci, për të diskutuar mbi paqen dhe sigurinë. Ato u fokusuan në situatën në Kosovë dhe Serbi, duke diskutuar

mbi mënyrat e përdorimit të RKSOKB 1325, për të siguruar përfshirjen e grave të të dyja vendeve në vendimmarrje.

Ngritja e Vetëdijes Lidhur me RKSOKB 1325

Që nga momenti i miratimit të RKSOKB 1325, aktivistet Kosovare kanë punuar në ngritjen e vetëdijes lidhur me rezolutën dhe me mënyrat në të cilat ajo do të mund të zbatohet në Kosovë, nga pikëpamja lokale dhe ndërkom-bëtare. Gjatë takimeve dymujore të RRGK-së, 85 anëtare të rrjetit rregullisht kanë diskutuar lidhur me rezolutën dhe zbatimin e saj. RRGK shpesh shkruan artikuj lidhur me RKSOKB 1325 në buletin e vet tremujor informativ, i cili botohet në formë elektronike dhe të shtypur, të quajtur Zëri i Grave Kosovare, i cili shpërndahet tek gati 5000 lexues. Përveç kësaj, RRGK dhe LGK rregullisht informojnë qytetarët lidhur me RKSOKB 1325 përmes mediave të shtypura dhe atyre elektronike; qindra debate, intervista, dhe artikuj lidhur me RKSOKB 1325 janë shkruar dhe/ose emituar në kanale televizive, që nga momenti i miratimit të rezolutës.

Avokimi për Pjesëmarrjen e Grave në Bisedimet për Statusin Final Politik të Kosovës

Në pranverë të vitit 2005, në pesëvjetorin e miratimit të Rezolutës 1325, RRGK u takua i dërgoi letër Kryeministrit, PSSP-së dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara, duke kërkuar që gratë të marrin pjesë në bisedimet për statusin final politik të Kosovës, i cili parashihej se do të fillojë në vjeshtë të vitit 2005 (shih www.womensnetwork.org). Kryeministri Kosumi letrës iu përgjigj duke theksuar se kabineti dhe ministrat janë të vetëdijshëm mbi rëndësinë e bashkëpunimit dhe konsultimit me aktorët e shoqërisë civile. Lobi i Gruas Kosovare gjithashtu ka dërguar një letër të ngjashme.

NGRITJA E PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË



Përveç avokimit, në nivel lokal dhe ndërkombëtar, mbi zbatimin e RKSOKB 1325, RRGK gjithashtu ishte aktive në sjelljen e zërave të grave deri tek vendimmarrësit politik. Në vitin 2005, përfaqësuesit e RRGK avokuan mbi çështje të ndryshme, bashkëpunuan me trupa qeveritarë vendor dhe ndërkombëtar mbi iniciativa të ndryshme, dhe punuan në drejtim të lidhjes së eksperteve me vendimmarrësit politik.

Takimi me Kryeministrin


Më 6 prill, anëtarët e Bordit të Drejtorëve dhe Drejtoresha Ekzekutive e RRGK u takuan me Kryeministrin e Kosovës Bajram Kosumi, për të diskutuar mbi zbatimin qeveritar të Planit Kombëtar të Veprimit për arritjen e Barazisë Gjinore, mbi Zyrën për Barazi Gjinore në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe përfshirjen e grave në bisedimet mbi statusin final politik të Kosovës.

Botimi i Hulumtimit Kosovar "Zëri i Grave"

Më 7 prill, në ditën ndërkombëtare të shëndetit, u publikua studimi "Zëri i Grave". Studimi ekzaminoi atë që gratë Kosovare, të të gjitha moshave, etnive dhe gjendjeve socio-ekonomike, konsiderojnë të jetë brenga kryesore, mënyrat në të cilat ato mendojnë që janë të trajtuara në mënyrë jo të barabartë, si dhe të drejtat që ato konsiderojnë se nuk respektohen. Studimi kishte për qëllim që të përkrahë përpjekjet që kryheshin për të avokuar për krijimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Arritjen e Barazisë Gjinore. OJQ-të vendore të grave ofruan këshilla dhe udhëzime mbi qasjen e studimit, veglat e hulumtimit dhe analizimin e të dhënave. RRGK luajti një rol përmbajtësor në të gjitha etapat e studimit. Ky studim u zhvillua dhe financua nga agjenci të OKB-së.

Konferenca Rajonale e Bankës Botërore në Greqi

Më 27-28 maj, Drejtoresha Ekzekutive e RRGK iu bashkëngjiti delegacionit zyrtar Kosovar, si përfaqësuese e shoqërisë civile, në një konferencë rajonale të organizuar nga Banka Botërore, me temën "Tregjet e Punës, Strategjitë për Zvogëlimin e Varfërisë", të mbajtur në Selanik të Greqisë. Udhëheqës i delegacionit ishte Ministri i Ekonomisë dhe Financave. Gjatë fjalimit të Drejtoreshës Ekzekutive, ajo përshkroi situatën aktuale ekonomike dhe ofroi rekomandime për përmirësimin e investimeve dhe ekonomisë në përgjithësi.



RRGK kontribui në raportin "Zëri i Grave", që u publikua me 7 Prill.

Fushata "Të njohim të Drejtat tona"

Në 29 nëntor të vitit 2004, RRGK lancoi një fushatë të quajtur "Të njohim të drejtat tona", e cila kishte për të informuar qytetarët e Kosovës mbi të drejtat dhe mekanizmat ekzistues gjinor që kanë në dispozicion. Pesë artiste të njohura Kosovare shfrytëzuan skeçe dhe këngë për të përshkruar situatat në të cilat mund të përdoren mekanizmat gjinor. Rrëfimet që shfrytëzuan bazoheshin në ngjarje të vërteta të përjetuara nga gratë Kosovare. Kjo shfaqje u përsërit edhe në Prizren dhe Mitrovicë. Gjatë vitit 2005 fushata vazhdoi me shfaqje në Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Gjiilan, Dragash, Romajë, Suharekë, Vushtrri, dhe Prizren. UNIFEM sponsoroi fushatën, përderisa RTV21 siguroi mbulimin medial.



Edona Reshitaj, Teuta Kurti dhe Alba Loxha duke kënduar "Vetëm Fol" gjatë fushatës "Të njohim të drejtat tona"



Gjatë fushatës "Të njohim të drejtat tona" publiku mund të bënte pyetje ose ti tregonin problemet me të cilat ballafaqoheshin.

Koalicioni për Reformë të Sistemit Zgjedhor

Më 8 korrik, koalicioni i ri për reformimin e sistemit zgjedhor organizoi një tryezë të rumbullakët mbi temën e tren-deve zgjedhore në Kosovë, dhe propozoi ndryshime në sistemin aktual zgjedhor të Kosovës. RRGK mori pjesë në komitetin organizativ, duke bashkëpunuar drejt përgatitjes të një koalicioni të gjërë të ngjashëm me atë Reforma 2004, i cili kërkonte ndryshime në sistemin zgjedhor gjatë vitit të kaluar.

Anëtarët e RRGK që Përfaqësojnë Strehimoret u Takuan me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Më 15 korrik, anëtarët e RRGK u takuan me Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Z. Selmanaj, për t'ia ngritur çështjen e mungesës së legjislacionit përkatës që adreson dhunën gjinore. Anëtarët e RRGK gjithashtu cekën se ligji mbi shërbimet sociale nuk zbatohet në tërësi, dhe se strehimoret nuk janë përfshirë në buxhetin e konsoliduar të Kosovës. Ato gjithashtu informuan ministrin se Departamenti i Drejtësisë i UNMIK-ut është i obliguar me ligj që të ndihmojë dhe përkrah rastet që arrijnë në strehimore, që rrjedhimisht do të thotë se Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes dhe UNMIK-u janë duke i shfrytëzuar shërbimet e strehimoreve pa i ndihmuar ata financiarisht. Ministri Selmanaj tha se institucionet janë të gatshme për t'i ndihmuar ato, por çështja kërkon përkushtim nga të dyja palët. Ai propozoi dhe pranoi të aranzhojë një takim me grupin parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, për t'ia adresuar këtë problem trupit më të lartë ligjvënës.

Raportimi tek OKB mbi Dhunën mbi Gratë në Kosovë

Në tetor, gjashtë anëtare të RRGK kontribuan në një raport të përpiluar nga Qendra Kosovare për Studime Gjinore, të dorëzuar drejtpërdrejt në Divizionin për Avancimin e Grave të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, i cili përmbante informata lidhur me disa faktorë që kontribuojnë në ngritjen e nivelit të dhunës ndaj grave në Kosovë; të dhëna mbi praktikën e mira të OJQ-ve që punojnë në këtë çështje; dhe rekomandime mbi hapat e ardhshëm që duhet të ndërmerren nga OKB, UNMIK, qeveria vendore dhe OJQ-të.



Anëtarët e RRGK-së u takuan me Z.Selmanaj, Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale për të diskutuar për strehimoret dhe dhunën ndaj femrave.

Përfshirja në Proceset Tjera Politike

Gjatë verës, si përfaqësues i shoqërisë civile, RRGK ishte i përfshirë në takimet e para të grupit punues për shndërrimin e Institucionit të Ombudspersonit nga strukturat e OKB-së në institucion kosovar. RRGK gjithashtu mori pjesë në një grup punues të quajtur "Ekspertët ligjor dhe Paneli Institucional për Sistemin e Ardhshëm Ligjor", një nga vendimmarrësit mbi themelimin e sistemit për ndihmë ligjore në Kosovë. Më 15 korrik, RRGK mori pjesë në një takim të organizuar nga Devizioni për Çështje Gjinore i Zyrës për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, me temë "Projekt-Strategjia për Drejta të Njeriut në Kosovë", duke u përqendruar më tepër në kapitullin për të drejta të gruas. RRGK ka marrë aktivisht pjesë në këto takime që nga fillimi i mbajtjes së tyre.

KRIJIMI I RRJETEVE DHE KËMBIMI I INFORMATAVE



Më 2005, përfaqësues të RRGK krijuan rrjete në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar, duke këmbyer përvoja përmes konferencave, punëtorive, takimeve dhe vizitave të punës.

Puna mes Anëtareve të RRGK dhe Partnerëve

Më 3 dhjetor 2004 RRGK mbajti takimin e vet të dytë vjetor në Prishtinë. Në takim RRGK zgjodhi dy anëtarë të ri të Bordit dhe vlerësoi punën e rrjetit për vitin 2004. Anëtarët gjithashtu diskutuan strategjinë e rrjetit për vitin 2005. Në vitin 2005 anëtarësia e rrjetit është rritur nga 70 në 85 anëtarë, duke e bërë RRGK rrjetin më të madh të organizatave joqeveritare në Kosovë dhe rajon. RRGK mbajti pesë takime dymujore koordinuese këtë vit, më 7 shkurt, 4 prill, 6 qershor, 5 shtator dhe 7 nëntor. Këto takime siguruan për anëtarët një forum në të cilin ata marrin informata aktuale mbi programet e RRGK, këmbëjnë informatat dhe përvojat me njëri tjetrin, ndërliken me organizatat dhe institucione ndërkombëtare, dhe iniciojnë



Në takimin vjetor të RRGK-së tri anëtare fituan gjëra për zyrë, në lojën shpërblyese.

veprimtari të përbashkëta. Rrjeti mbajti mbledhjen vjetore të anëtarësisë me 3 Dhjetor ku anëtarët vlerësuan punën e Rrjetit në 2005, zgjodhën dy anëtarë bordi dhe bënë rekomandime për strategjinë e Rrjetit në 2006, në çështje si fuqizimi i Rrjetit, fuqizimi politik i grave dhe avokimi për të drejtat e grave.

Programi Informativ i RRGK

RRGK ka vazhduar zhvillimin e programit të vet informativ i cili mëton që të mbajë anëtarët dhe partnerët lokal dhe ndërkombëtar të informuar lidhur me iniciativat e rrjetit dhe të anëtareve. Botimet e pranverës, verës dhe vjeshtës të buletinit informativ "Zëri i Grave" të vitit 2005, i janë shpërndarë opinionit të gjerë si në formë elektronike ashtu edhe në atë të shtypur, në të tri gjuhët: Shqip, Serbisht dhe Anglisht. Përveç kësaj, web-faqja ka fituar një pamje të re në vitin 2005. Ajo aktualizohet rregullisht dhe në të vendosen informata mbi veprimtaritë e RRGK dhe të anëtareve të saj. Ajo gjithashtu përmban lidhje me ueb-faqet e partnerëve, publikime dhe informata tjera të dobishme. RRGK gjithashtu ka adresë të re elektronike: info@womensnetwork.org.

Ngritja e Kapaciteteve të Punonjësve të RRGK

Më 21 korrik, të sapo punësuarit në RRGK mbajtën një trajnim njëditor në vend të punës. Së pari ata diskutuan si të përpilohen projekt-propozimet. Pastaj ata diskutuan mbi historinë dhe partnerët e RRGK në mënyrë që të kuptojnë më mirë pyetjet dhe çështjet lidhur me rrjetin. Së treti, në bashkëpunim me këshilltarë, të sapo punësuarit në RRGK krijuan një projekt-informatë dhe strategji për vitet 2005 dhe 2006.

Fondi për Veprime Urgjente Vizitoi Kosovën

Më 16 dhjetor 2004, përfaqësues të Fondit për Veprime Urgjente (FVU) nga Shtetet e Bashkuara u takuan me anëtarë të RRGK në Prishtinë. Përfaqësuesit e FVU kontribuan në diskutimet për krijimin e Fondit të Kosovës për Gratë.

Bashkëpunimi Rajonal me Homologët Rajonal në Përgatitje për Beijing +10

Më 12-13 dhjetor të vitit 2004, RRGK dërgoi tri gra për të marrë pjesë në Forumin e OJQ për Takimin Përgatitor Rajonal për Beijing +10, në Gjenevë të Zvicrës, organizuar nga Komisionin Ekonomik për Evropë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNECE). Temat kryesore të shqyrtimit të Beijing +10 ishin: gratë në ekonomi, mekanizmat institucional për promovimin e barazisë gjinore. Trafikimi i grave në kontekst të lëvizjeve migruese, dhe çështje tjera. Pjesëmarrja e grave Kosovare në Gjenevë u përkrah financiarisht nga Programi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP).

Krijimi i Rrjeteve dhe Këmbimi i Përvojave gjatë Beijing +10, në Nju Jork

Në mars të vitit 2005, delegatet nga Kosova, Luljeta Vuniqi, Igballe Rogova, Sevdije Ahmeti, dhe Fehmiye Gashi morën pjesë në konferencën Beijing +10, në Nju Jork. Gjatë konferencës, Drejtoresha Ekzekutive e RRGK pati tri prezantime. Tek lansimi i Fondit për Veprime Urgjente 'Rising Up in Response: Women's Rights Activism in Conflict' nga Jane Barry; tek Misioni i Mbretërisë së Bashkuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Në të dyja këto ngjarje,

Drejtoresha Ekzekutive e RRGK foli lidhur me mënyrën si organizatat ndërkombëtare duhet trajtuar gratë dhe aktivistet në vendet pas konfliktit. Ajo gjithashtu prezantoi përvojën e Kosovareve në zbatimin e rezolutës 1325. Përfaqësueset e RRGK morën pjesë në një ngjarje të organizuar nga Instituti për Shoqëri të Hapur, të quajtur "Përpjekjet për avokim për Beijing +10 në Vendet Post-Socialiste në Tranzicion". Drejtoresha Ekzekutive e RRGK mori pjesë në një diskutim të emëruar "Gratë zhvillojnë paqe", në të cilin ambasadori Anwarul K. Chowdhury përshkroi përvojën e tij në Kosovë në vitin 2001, si kryesues i një delegacioni të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. RRGK publikisht lavdëroi Ambasadorin Chowdhury për punën e tij për përf forcimin e zbatimit të RKSOKB 1325.



Gjatë Konferencës Beijing +10, të mbajtur në Mars, morën pjesë edhe përfaqësues të RRGK-së.

Delegacioni i RRGK Viziton SHBA-të, përmes 'Participant Training Program'

Përmes programit trajnues 'World Learning Participant Training Program', të financuar nga USAID, një ekip 9 anëtarësh nga RRGK vizitoi grupet kryesore avokuese të grave në Shtetet e Bashkuara, prej 17 shtator deri më 1 tetor. Ky udhëtim, i organizuar nga PeopleWork dhe 'Center for Women in Government and Civil Society (Albany)', kishte për qëllim ngritjen e aftësive të delegacionit për avokim dhe krijimin e mënyrave konkrete për përforsimin e bashkëpunimit me gratë në pozita udhëheqëse, si në sektorin e politikës ashtu edhe në atë privat. Grupet me të cilat delegacioni i RRGK është takuar gjatë vizitës përfshijnë: në Washington, D.C. - me Emily's List, the National Women's Political Caucus and League of Women Voters; në Albany, New York, Guvernatorin e shtetit New York, Znj. Mary O. Donahue, New York State Coalition Against Domestic

Violence, TV Station WNYT Channel 13, Equinox, The Legal Project, United Way Foundation, Global Democracy Programs, Women's Fund of Northeastern New York dhe me Center for Women in Government and Civil Society; dhe në New York City, National Council for Research on Women, the White House Project, Equality Now, Open Society Institute, Përfaqësuesen e shtetit të New York Znj. Deborah Glick, Women's Commission for Refugee Women and Children, UNIFEM, Fondacionin dhe Zyrën e Senatores së SHBA Znj. Hillary Clinton. Delegacioni i RRGK kaloi një fundjavë me Organizatën Shqiptaro-Amerikane të Gruas Motrat Qiriazhi gjatë takimit të quajtur "Empower Yourself" në Jeronimo Resort Center. Kjo paraqiti një mundësi të mirë të kombinimit të relaksimit dhe shërimit me zhvillimin profesional dhe personal.



Kryeministri Bajram Kosumi, Shefi i Misionit Amerikan Phillip Goldberg, dhe Drejtori i USAID Ken Yamashita përgëzojnë përfaqësueset e RRGK-së për përfundimin e 'Participant Training Program'

Këmbimi i Përvojave për Strategjitë Globale të Grave

Më 10-13 shtator, Drejtoresha Ekzekutive e RRGGK prezantoi punën e rrjetit në konferencën ndërkombëtare "Strategjitë Globale të Gruas për Shekullin 21", në Nju Jork.

Konferenca e AWID "Si Ndodh Ndryshimi?" në Bangkok

Më 28 dhe 29 tetor, më se 1,800 pjesëmarrës nga 120 vende u takuan në Bangkok për të diskutuar mbi temën "Si ndodh ndryshimi", në një konferencë të organizuar nga Shoqata për Zhvillimin e Drejtave të Gruas (AWID). Pesë Kosovare morën pjesë. Gjatë një seance në të cilën ishte një nga folëset, Drejtoresha Ekzekutive e RRGGK theksoi rëndësinë e përfshirjes së grave në vendimmarrje në vendet që kanë kaluar nëpër konflikt.

Në tetor, RRGGK mori pjesë në Konferencën e AWID "Si Ndodh Ndryshimi?", të mbajtur në Bangkok



SHËNDETI I GRAVE

RRGGK Ndihmoi në Krijimin e Grupeve Përkrahëse për Nënën që Ushqejnë Foshnjat me Gji

Duke filluar që nga tetori i vitit 2004 e deri në mars të vitit 2005, anëtarët e RRGGK morën pjesë në "Gratë për Gratë - Grupi Përkrahës për Nënën që ushqejnë me gji foshnjat". Projekti u realizua në bashkëpunim me UNICEF-it, Grupit Punues për Iniciativën Kosovare për Spitale Miqësore për Foshnje (BFHI) dhe OJQ-ve lokale. Ky projekt i financuar

nga UNICEF-i kishte për qëllim të ngrisë nivelin e ushqimit ekskluziv me gji duke krijuar grupe përkrahëse funksionale dhe të përmbytshme të tipit "gratë për gratë". Grupet kryesisht përkrahnin dhe promovonin ushqimin me gji në nivel të bashkësive.

PROGRAMET E ARDHSHE

Gjatë takimit vjetor të Anëtarësisë së RRGGK në dhjetor të vitit 2005, anëtarët e rrjetit vendosën që gjatë vitit 2006 të ndërmarrin iniciativat në vijim, bazuar në rekomandimet e bëra në tri grupe punuese: fuqizimi i rrjeteve, fuqizimi politik i grave, dhe avokimi për drejta të grave.

Fuqizimi i Rrjeteve

Në vitin 2006, zyra koordinuese e rrjetit në Prishtinë do të punojnë në prezantimin e informatave më të hollësishme lidhur me veprimtaritë e anëtareve të ndryshme të RRGGK përmes ueb-faqes së RRGGK dhe buletinit informativ "Zëri i Gruas". RRGGK do të takohet ndaras me anëtarët e veta, për t'i mbledhur dhe këmbyer informatat.

Fuqizimi Politik i Grave

RRGGK krijoi një grup punues lidhur me këtë çështje, i cili do të takohet me qeverinë, Organizatën e Kombeve të Bashkuara dhe grupin e kontaktit. Në vitin 2006, RRGGK to të riaktivizojë 30 grupet avokuese komunale të cilat krijuan gjatë fushatës "Partitë Politike Punojnë për Gratë". Anëtarët e RRGGK do të punojnë për të ngritur vetëdijen e femrave dhe meshkujve lidhur me sistemin zgjedhor. Në bashkëpunim me RRGGK, ato do të ngrisin nivelin e komunikimit mes politikanëve dhe votuesve, edhe jashtë fushatave zgjedhore. Rrjeti do të vazhdojë të avokojë për zbatimin RKSO KB 1325, posaçërisht për përfshirjen më të mirë të grave në procesin e bisedimeve për statusin final politik të Kosovës.



Avokimi për të Drejtat e Grave

RRGGK gjithashtu ka formuar një grup punues lidhur me këtë çështje, i cili do të punojnë në ngritjen e vetëdijes lidhur me çështjet shëndetësore të grave, siç është kanceri i gjirit. Grupi punues gjithashtu do të koordinojë me organizatat partnere për të organizuar një fushatë kundër trafikimit të femrave, që do të përfshijë ngritjen e vetëdijes të nxënësve të shkollave të mesme, një fushatë mediale, diskutime nëpër tryeza të rrumbullakëta, dhe bashkëpunim të ngushtë me institucionet qeveritare, posaçërisht me gjykatat, policinë, dhe KFOR-in.

ANËTARËT TANË

ORGANIZATA	KONTAKTI	TELEFONI	E - MAIL	LOKACIONI
Afrodita	Marie Kurti	044 286 319	ugafrodita@hotmail.com	Ferizaj
Alma	Shemsije Seferi	044 257 443	shemsijeseferi@hotmail.com	Pejë
Antigona	Rabe Rrustemi	044 192 232	r_rrustemi@hotmail.com	Skenderaj
Ato	Naile Zahiti	044 384 278		Vushtrri
Aureola	Sanije Grajcevc	044 502 578	aureola_p95@hotmail.com	Prishtinë
Bagëti e Bujqësi	Zahide Gashi	044 160 699	zahidegashi@hotmail.com	Prishtinë
Bardha	Raza Sadrija	044 249 700		Prishtinë
Briga	Simonovic Miroslavka	063 7210 616	miroslavka_briga@yahoo.com	Gorazdevac
Centari Romane Gjuvlenge	Emsale Mergjollari	044 274 671	emsaalmergjollari@hotmail.com	Prizren
Dera e Hapur	Belgjyzare Muharremi	044 124 423	betimuharremi@hotmail.com	Prishtinë
Diana	Silvana Vokshi	044 206 321		Gjakovë
Dora Dorës	Vjosa Curri	044 216 616	dora_dores@yahoo.com	Prizren
Dua	Ilirjana Kryeziu	044 309 439	ojq_dua@yahoo.com	Prizren
Elena Gjika	Lale Grabanica	044 199 167	grabanica@hotmail.com	Klinë
Era e Ndryshimeve	Nizaqete Spahiu	044 203 442	nizaqetespahiu@yahoo.com	Dragash
Femrat në Veprim	Igballe Hakiqi	044 171 166	igballehakiqi@yahoo.com	Podujevë
Fillesa	Drita Myftiu	044 336 904	fillesa@yahoo.com	Prizren

ORGANIZATA	KONTAKTI	TELEFONI	E - MAIL	LOKACIONI
Flaka	Shehindere Dedushi	044 195 940	delidedushi@hotmail.com	Lipjan
Foleja	Gjyzel Shaljani	044 219 612	gjyzelshaljani@gmail.com	Prizren
Gruaja Bashkohore	Fetije Mehmeti	044 305 135	fitness.pz@yahoo.com	Prizren
Gruaja Familjare	Nadire Kryeziu	044 217 223	gruaja_familjare@hotmail.com	Prizren
Gruaja për Gruan	Shemsije Xhaferi	044 155 286	shemsije_xhaferi@hotmail.com	Rahovec
Gruaja Sot	Shyhrete Besimi	029 625 499	gruajasot@hotmail.com	Prizren
Grupi i Veteranëve të Arsimit	Naxhiqe Buqinca	044 233 633	naxhi_gva@hotmail.com	Prishtinë
Hadër	Resmije Krasniqi	044 278 538	haderprizren@hotmail.com	Prizren
Handikos	Drita Vukshinaj	044 263 636	handikos_pz@hotmail.com	Prizren
HANDIKOS, Femrat me Aftësi të Kufizuar	Mehreme Llumnica	044 198 688	mehremellumnica@hotmail.com	Prishtinë
Hanëmeli	Lirije Gash	038 211 274	liriyegas@hotmail.com	Prishtinë
Hareja	Sahadete Dula	044 230 711	shpg_hareja@hotmail.com	Rahovec
Idemo Pravo	Zhivodinka Radosavlevic	063 825 3112		Plemetin
IFK Vizioni i Ri	Ardita Rizvanolli	044 123 274	kwi_nv@hotmail.com	Gjakovë
Jeta Ime	Shqipe Bejtullahu	044 188 336	mylife_center@yahoo.com	Gjakovë
Live Life	Xhylnaze Bytyqi	044 187 021	jeto_jeten2001@yahoo.com	Prizren
Kalabria	Sevdie Bunjaku	044 234 190	kalabria24@hotmail.com	Prishtinë
Kevser	Igballe Huduti	044 142 038	kewther_pz@yahoo.com	Prizren

ORGANIZATA	KONTAKTI	TELEFONI	E - MAIL	LOKACIONI
KHWA	Gjylfidane Morina	044 394 226	khwa03@hotmail.com	Pejë
Komiteti i Grave të Verbëra, SHVPDK	Bajramshahe Jetullahu	044 185 298	kgvk_b@hotmail.com	Prishtinë
Koraci Buducnosti	Smiljana Veselinovic	038 64 202		Gracanica
Kosova Rehabilitation Center	Feride Rushiti	044 501 904	krct_org@yahoo.com	Prishtinë
Kosovarja	Ferjalle Vula	044 122 601	ferjallvula@yahoo.com	Gjakovë
Kosovarja Prizrenase	Dita Arapi	044 168 877	ditaarapi@hotmail.com	Prizren
Kryefamiljarja	Sevdije Sadiku	044 187 311	kryefamiljarja@hotmail.com	Suharekë
Legjenda	Melihate Osmani	044 194 045	meliosmani@yahoo.com	Viti
Lepsa Buducnost	Radosava Mirkovic	063 868 1655	stivicr55@yahoo.com	Priluzje
Liria	Nazife Jonuzi	044 504 123	liriagjilan@hotmail.com	Gjilan
Liria	Luljete Kuqi	044 186 824	luljetakuqi@hotmail.com	Suharekë
Lufto Jetën	Nezaqete Idrizi	044 168 446	lufto_jeten@hotmail.com	Prizren
Lulebora	Selvete Gashi	044 110 970	lulebora@yahoo.com	Prishtinë
Lulishtja	Sadije Dulahu	044 374 412	sadiedulahu@hotmail.com	Dabishevc
LWF	Shyhrete Peci	044 157 287	sh_peci@hotmail.com	Mitrovicë
MDRI	Dea Pallaska	044 126 255	dpallaska@mdri.org	Prishtinë
Medica Kosova	Veprorre Shehu	0390 21 139	medicam_kosova@yahoo.com	Gjakovë
Mësuesja	Myrvete Shurdhani	044 239 748	mshurdhani@yahoo.com	Prishtinë

ORGANIZATA	KONTAKTI	TELEFONI	E - MAIL	LOKACIONI
Motrat Qiriaz	Marte Prekpalaj	044 113 258	motratqiriazhas@yahoo.com	Has, Prizren
Ne Jemi Pjesë e Botës	Atifete Demaj	044 239 814	njpb04@hotmail.com	Fushë Kosovë
NORMA	Valbona Salihu	044 264 840	shnorma@hotmail.com	Prishtinë
OJQ e Femrave për Hulumtime Etnologjike	Shpresa Siqeca	044 350 023	shpresasiqeca808@yahoo.com	Prizren
OJQ Jeta	Safete Gacaferri	044 253 412	ojqjeta@yahoo.com	Decan
One to One - QKGFF	Merita Halitaj	044 172 644	qkgff_kosova@hotmail.com	Pejë
Organizata e Gruas "Fortesa"	Sanije Jahiri	044 643 665	sanije200@hotmail.com	Kamenicë
Organizata e Gruas së Pamvarur	Rudina Gerdeci Llapashtica	044 308 758	aibikosovo@libero.it	Prishtinë
Organizata për Aktivitete Zhvillimore "ODA"	Violeta Selimi	044 318 982	vselimi@atoda.org	Prishtinë
Organizata për Pëkrahje dhe Edukim të Rinisë	Nurije Ferati Haziri	044 257 316	oper@hotmail.com	Prishtinë
Promocom	Shpresa Mazreku	044 204 065	ngo-promocom@hotmail.com	Rahovec
Qendra Mbro Viktimën Parandallo Trafikimin	Hamijet Dedolli	044 167 395	pvpt_ngosuzi@hotmail.com	Prishtinë
Qendra Kosovare për Studime Gjinore	Luljeta Vunij	044 116 898	qksgj_kgsc@yahoo.com	Prishtinë
Qendra për Gra dhe Fëmijë ASEBE	Elita Reshtani	044 190 411	asebe_prizren@hotmail.com	Prizren

ORGANIZATA	KONTAKTI	TELEFONI	E - MAIL	LOKACIONI
Qendra për Mirëqenien e Gruas	Lumniye Decani	044 111 678	pejawwc@yahoo.com	Pejë
Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore	Arjeta Rexha	044 124 612	arjetare@hotmail.com qtsgj@hotmail.com	Prishtinë
Qendra e Resurse e OJQ-ve	Esmat Smajli	029 31 357	ngoprizren@yahoo.com	Prizren
Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve	Sevdije Ahmeti	044 143 716	cpwc@cpwc-qmgf.org	Prishtinë
REA	Reafete Rexhepi	044 219 215	rafete_r@hotmail.com	Ferizaj
Romane Romanja	Shpresa Agushi	044 211 905	agushishpresa@yahoo.com	Gjilan
Ruka + Ruci	Nevenka Rikallo	063 8814 472	rikalonevenka@yahoo.com	Fushë Kosovë
Sara	Dashurije Sahiti	044 244 967	ojq_sara@hotmail.com	Dragash
Sh.G.A.K. Edona	Hazife Hajdini	044 254 315	ngoedona@yahoo.com	Ferizaj
SHE - ERA	Mirlinda Kusari	044 122 696	wsheera@gmail.com	Gjakovë
Shoqata e Gruas	Mybera Valla	0390 24 563	shoqataegruas@yahoo.com	Gjakovë
Shoqata e Gruas "Zana"	Tahire Gashi	044 406 812	shg_zana@hotmail.com	Klinë
Shoqata e Gruas dhe Fëmijëve "NARDI"	Violeta Shehu	044 312 889	nardi_99@hotmail.com	Prishtinë
Shoqata për Informimin dhe Arsimimin e Gruas	Kismete Hyseni	044 115 583	kismete_h@hotmail.com	Prishtinë
Shtëpia e Sigurtë	Sakibe Doli Dobruna	044 161 857	linjajuaj@yahoo.com	Gjakovë


ORGANIZATA	KONTAKTI	TELEFONI	E - MAIL	LOKACIONI
Sibora	Hyrmete Celina	044 247 240	sibora_pz@yahoo.com	Prizren
Sirena	Vezire Maliqi	044 638 595	ojqsirena@yahoo.com	Ferizaj
Teuta	Nexhmije Bytyqi	044 216 623	nexhmijeb@yahoo.com	Prishtinë
Violete	Bedrije Shala	044 317 652	ojqviolete@hotmail.com	Prishtinë
Vita - Jeta	Sanije Nimani	044 199 395	shjpgvitajeta@yahoo.com	Prishtinë
Women for Women International	Hamide Latifi	044 503 499	wfwi_k@hotmail.com	Prishtinë
Yllka	Zejnepe Reçica	044 280 648		Ferizaj

RAPORTI FINANCIAR 2005

DONATORI	EMRI I PROJEKTIT	SHUMA E PRANUAR	SHUMA E SHPENZUAR	SHUMA E MBETUR
Kvinna till Kvinna	Ngritja e Kapaciteteve	€28,476.00		
Swiss Development Agency for Cooperation	Avokuese të RRGK	€26,775.00	€55,251.00	€0.00
UNIFEM	Rezoluta 1325 I	€8,260.00	€8,128.28	€131.72
UNIFEM	Të njohim të Drejtat tona I		€10,799.92	€0.00
UNIFEM	Të njohim të Drejtat tona II	€34,250.00	€22,258.50	€1,191.58
UNIFEM	Rezoluta 1325 II	€11,409.00		€11,409.00
UNICEF (29,12,04 - 31,03,05)	Gratë përkrahin Gratë	€2,628.00	€2,628.00	€0.00
Totali		€111,798.00	€99,065.70	€12,732.30

Shpenzimet e Programeve dhe të Zyrës

Shpenzimet e Zyrës	€28,465.00	25.46%
Shpenzimet e Programeve	€70,600.70	63.15%
Totali i Shpenzuar	€99,065.70	
Balanci	€12,732.30	11.39%



RRJETI I GRUPEVE TE GRAVE TE KOSOVES (RRGGK)

RAPORT I PAVARUR I AUDITORIT


Per : Igballe Rogoven
Drejtoreshe ekzekutive
Rrjeti I Grupeve te Grave te Kosoves (RRGGK)
Prishtine

Ne kemi audituar shpenzimet dhe te dhenat suplementare financiare te Rrjetit te Grupeve te Grave te Kosoves (RRGGK), shprehur ne Euro, per periudhen janar – dhjetor 2005. Deklaratat financiare dhe te dhenat suplementare financiare, jane pergjegjesi e menaxhmentit te programeve. Pergjegjesia jone eshte te shprehim mendimin per te dhenat e lartepermendura, bazuar ne auditimin tone.

Ne kemi udhehequr procesin e auditimit sipas Standardeve Nderkombetare te Auditimit (ISA). Keto standarde kerkojne qe procesi i auditimit te planifikohet dhe udhehiqet ne menyren qe mundeson sigurimin se formularet raportues nuk permbajne deklarata te gabuara materiale. Auditimi perfshine kontrollimin, ne baze testi, e te dhenave qe vertetojne shumat e deklaruar ne formularet e raportimit, auditimi perfshine gjithashtu vleresimin e principeve te perdorura gjate llogaritjes dhe vleresimeve sinjifikante te bera nga ana e menaxhmentit, sikurse edhe vleresimin e te dhenave te raportuara ne deklaratat financiare. Ne besojme se auditimi yne ofron nje baze te arsyeshme per mendimin tone.

Sipas mendimit tone, informatat financiare paraqesin ne menyre te drejte ne te gjitha aspektet materiale, shpenzimet e Rrjetit te Grupeve te Grave te Kosoves (RRGGK) gjate periudhes se lartepermendur dhe se rezultatet e punes jane ne pajtuesmeri me Standardet Nderkombetare te Kontabilitetit dhe me Standardet Kosovare te Kontabilitetit.

Prishtine
16 maj 2006

AUDITOR

XHEMAIL SYLA
Auditor i Licencuar
Licensed Auditor

STAFI I RRJETIT 2005

Igballe Rogova
Drejtoreshë Ekzekutive

Elita Gota
Menaxhere e Programit (Janar - Prill)

Arbnora Kastrati
Menaxhere e Programit (Korrik - Gusht)

Besa Shehu
Menaxhere e Financave (Mars)

Nexhmije Fetahu
Menaxhere e Programit (Tetor)

Kontribuesit Tjerë

Nicole Farnsworth
Këshilltare për Informata dhe Ngritje Fondesh

Jessica Glynn
Këshilltare për Informata (Qershor - Gusht)

Lauren Bean
Praktikante (Shtator - Tetor)

Shkruar dhe Dizejnuar nga
Alba Loxha dhe **Nicole Farnsworth**

Financuar nga
Rockefeller Brothers Fund



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Tel: +381 (0)38 245 850
E-mail: info@womensnetwork.org
Adresa: Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8
Prishtinë, Kosova
www.womensnetwork.org